



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:078464

Datë: 20.02.2024

Numri i dokumentit: 05349596

KPPP.nr. 1921/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjiellit “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala”, nr. 4, kundër debitorit “Tregtia” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810024448 dhe seli në Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 30/22, i lejuar me datë 28.02.2022, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 20.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Tregtia” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810024448 dhe seli në Fushë Kosovë, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 30/22, i lejuar me datë 28.02.2022, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori, për borxhin në shumë prej EUR 13,779.14 dhe në këtë pjesë të përmbartimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Tregtia” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810024448 dhe seli në Fushë Kosovë, ashtu që pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 30/22, i lejuar me datë 28.02.2022, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori, sa i përket borxhit në shumë prej EUR 694.67, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjiellit “Prishtina” Sh.A., mbi bazën e ekstraktit të verifikuar nga librat afariste me shifër 481, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 30/22, të datës 28.02.2022, me të cilin është urdhëruar debitori, që,

brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 14,473.80, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbarimit me arsyetim se borxhi i kërkuar nga kreditorit sipas dokumentit të besueshëm është përfshi në parashkrim në kuptim të nenit 355 të LMD-së, ngase sipas kartelës financiare borxhi para datës 31.12.2013 ka qenë në vlerë prej 13,668.63, borxh ky i akumuluar para shumë vitesh. Ndërsa, ka shtuar se nga pjesa tjetër e borxhit i cili nuk është përfshi në parashkrim në lartësi prej EUR 805.17, janë paguar detyrimet në lartësi prej EUR 110.50. Ndërsa, për shumën e ngelur pa paguar në lartësi prej EUR 694.67, e njejta nuk i takon debitorit ngase fabrika e betoni ku është ngarkuar ky borxh është bartur tek një pronar tjetër dhe rrjedhimisht nuk është përgjegjësi e debitorit. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta pranoj si të bazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të anulohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke ju referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.2 e të njëjtit nen përcakton ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave si dokumente të besueshme sipas së cilave mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht ekstraktin e verifikuar nga librat afarist me shifër 481, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, meqenëse në ekstrakt janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë përshkruar shërbimet të

cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Ndërsa, pas vlerësimi të pretendimeve të debitorit lidhur me afatin e parashkrimit, gjykata ka shqyrtuar ekstraktin mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor në raport me faturat e përfshira ekstrakt dhe në mbështetje të dispozitave nga 355 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Sipas nenit 355.1 të LMD-së, “1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”. Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat e përfshira në ekstrakt nga data 31.12.2013 deri me datën 01.02.2019, në shumën prej EUR 13,668.63 kanë arritur afatin e parashkrimit, ngase propozimi për përmbarim nga ana e kreditorit në raport me faturimet për këtë periudhë kohore është paraqitur me datë 28.02.2022, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e arritjes për pagesë.

Ndërsa, sa i përket borxhit sipas faturave mujore të pasqyruara në ekstrakt për periudhën kohore 28.02.2019 e deri me datë 28.02.2022, në shumën prej EUR 805.17, për të cilën periudhë kërkesat e kreditorit nuk janë përfshi në parashkrim në kuptim të nenit 355 të LMD-së, gjykata gjeti se debitori ka përmbushur detyrimin pjesërisht dhe atë duke paguar vlerën prej EUR 247.97, përmes transaksioneve bankare të evidentuara në ekstraktin mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor, ashtu që tani borxhi i mbetur i debitorit është në lartësi prej EUR 694.67.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12.2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: “Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit, duke përfunduar procedurën përmbarimor për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 13,779.14.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenit

13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1921/22, datë 20.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.